

Hyjnor, dhe nuk kisha asnje njohuri apo kualifikim ne fusha te tjera. Dhe nese Doktrina nuk zbriti nga Informacioni, nga erdhi?

Informacioni eshte komunikim i drejtperdrejte dhe public. Ai ka dhene qindra e qindra zgjidhje, qofte edhe personale, te cilat terhoqen vemendjen dhe respektin e te gjitha shtresave shoqerore ne Shqiperi dhe me gjere. Eshte ky Informacion qe ne vitin 1989 u dha njerezve lajmin e mire se do te hapen Vendet e Shenjta ne Shqiperi. Kush e dinte ne ate kohe se do te rrezohet regjimi komunist? Gjithashtu ne vitin 1997, ne Bullgari, Informacioni solli mesazhin: *“Kosovaret te mos e nderpresin rrugen per Identitet. Ajo cka do te humbin do te rigjenerohet me jetet e tyre qe do te marrin kuptim. Shen Maria do te shfaqet perseri atje. Shqiperia do t'i prese dhe do t'i ndihmoje kosovaret si jeta jeten. Zoti dhe njerezit jane dashuri se vijne po nga Ajo”*. Dhe vertet Shqiperia i priti Kosovaret si jeta jeten dhe Zoti dha dashuri. Per me tej Kosova fitoi Pavaresine.

Detyrat e mija themelore jane: Sjellja e Doktrines, ndertimi i Objekteve te Shenjta, Organizimi dhe strukturimi i Misionit, dhe sherbimi lutjesor. Pra, verifikimi i mashtrimeve te paraqitura si raste te verteta nuk eshte atribut i imi edhe pse jam juriste. Por le ti japim pergjigje “akuzes” “nje ndihme qe nuk e dergon”. Proceset spirituale dhe lutjesore nuk maten me mashtrimet e pseudobesimtareve. Ne cdo kishe apo xhami, prezantimi i nje probleml nga besimtari merret ne mirebesim sepse nuk ka arsye qe te kontrollohet. Detyra e punonjesve shpirterore eshte t'i presin, t'i orientojne me lutjet perkatese, dhe te luten se bashku. Nese dikush vjen ne vendin shpirteror dhe thote po me vdes femija, shpirteroret nuk shkojne te verifikojne faktin, por nxitojne te luten.

Sa per versionin “pranon para”, askush nuk mund te akuzoje per marrje parash per kontributet dhe donacionet vullnetare qe besimtares japin apo dergojne ne vendin shpirteror. Nese dikush mashtron me nje problem fiktiv, dhe ne vazhdimesi te mashtrimit ben nje donacion per ta perdorur si “dokument” me pas, verteton me fakte se ai eshte mashtruesi. Pse mendoj se i sherbehet qellimit kriminal? Sepse jane te shumte ata qe deshirojne ta kene ate truall, e ne mos truallin parate qe do te fitojne duke ia dhene ate dikujt tjeter. Megjithate, persa kemi dale ne tregun e medias, do te luftojme qe seicili te zere vendin e vet.

KRYETARE

E MISIONIT SHENJTEROR ELEONORE

ZONJA E SHPIRTIT ELEONORA BREGU

